

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Nëntor 1982
Viti i botimit XXIX

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës nr. 210 të Tiranës	5
NGA PUNIMET E PLENUMIT TË 5-TË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH	
— Komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror të PPSH	24
PALI MISKA — Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës (Raport i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH)	34
ME RASTIN E 70-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË KOMBËTARE	
SH. BALLVORA — Pavarësinë kombëtare popullore ynë e ka fituar dhe mbrojtur me forcat e veta	40
PROBLEME TË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË	
R. LIKA — Krahas zhvillimit të forcave prodhuese përsosen edhe anë të veçanta të marrëdhënieve socialiste në prodhim	50
H. DIBRA — Përsosja e standardeve — faktor i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së prodhimeve	62
M. BALANI — Vetëm rendi i vërtetë socialist garanton e respekton personalitetin dhe të drejtat e njeriut punonjës	71
G. PASHKO — Manipulimet imperialiste të çmimit të naftës — përshpejtues të thellimit të krizës energjetike	79
N. SHEHU — M. FERRA — Demagogjia revizioniste dhe e vërteta mbi natyrën e marrëdhënieve të pronësisë në bujqësinë sovjetike	89

ENVER HOXHA

**FJALA NË TAKIMIN ME ZGJEDHËSIT
E ZONËS NR. 210 TË TIRANËS**

Të dashur shokë e shoqe, zgjedhës e zgjedhëse,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem këtu midis jush, njerëzve të dashur të kryeqytetit tonë të shtrenjtë dhe t'ju falënderoj për nderin e madh që më bëtë, duke më caktuar si kandidatin tuaj për deputet në Kuvendin Popullor. Besimi juaj ndaj personit tim i përket Partisë sonë të lavdishme, që na solli këto ditë të bardha që gëzojmë sot dhe që na udhëheq me mendje të kthjellët e dorë të sigurt drejt një të ardhmeje akoma më të mirë e më të bukur. Partia na mësoi ne, bijtë e saj, si të luftojmë e si të punojmë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ishte ajo që na bëri të ndërgjegjshëm për çështjen e klasës punëtore, ajo na dha mendtë e fuqinë për t'i shërbyer çështjes së ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Prandaj, si në çdo moment tjetër, edhe në këto çaste solemne, kur po përgatitemi të votojmë për ripërtëritjen e Kuvendit Popullor, mendimet tona më të mira, ndjenjat tona të dashurisë e të mirënjohjes së thellë i drejtohen Partisë, vijës së saj të drejtë, besnikërisë së saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit.

Po bëhen katër dekada që ne jetojmë e punojmë të lirë në atdheun tonë. Kur shikojmë rrugën e përshkuar, të gjithë ndiejmë një gëzim të madh për sukseset e arritura dhe një krenari të ligjshme për mundin që kanë bërë e për djersën që kanë derdhur njerëzit tanë. Kjo periudhë do të mbetet në histori si periudha kur u shfaqën me tërë forcën e tyre vitaliteti dhe gjallëria e popullit tonë, fryma e tij luftarake dhe këmbëngulja në punë, etja e madhe për të mësuar dhe shpirti përparimtar. Ishin këto virtyte të larta, që Partia diti t'i nxjerrë në dritë dhe t'i shndërrojë në një forcë të madhe lëvizëse, që bënë të mundur kryerjen e shpejtë dhe me sukses të të gjitha atyre transformimeve të mëdha shoqërore-ekonomike që i kemi jetuar. Ishte ai karakter lirishtashës e revolucionar i njerëzve tanë, ishin mësimet që ata kishin nxjerrë nga e kaluara e hidhur, kur Shqipërinë e sundonin dhe e shtypnin të huajt, që i shtynë ata të bashkohen grusht rreth Partisë dhe, nën udhëheqjen e saj, të luftojnë e të dalin fitimtarë mbi komplotet e ndërhyrjet e imperialistëve dhe mbi tradhtinë e revizionistëve modernë, jugosllavë, sovjetikë e kinezë.

Për të gjithë ne, për mbarë popullin tonë, zgjedhjet e Kuvendit Popullor janë një rast për t'u takuar e biseduar, për të bërë bilancin e punës së kryer dhe për të shqyrtuar detyrat që na presin.

Zgjedhjet e reja e gjejnë Shqipërinë të sigurt në fatet e veta, një vend që qëndron fort mbi këmbët e tij, që perspektivën e ka të qartë dhe të ardhmen të garantuar. Kurrë ndonjëherë populli shqiptar nuk ka qenë i bashkuar në interesa, në pikëpamjet politike e ideologjike, në normat morale e në sjelljet shoqërore siç është sot. Ky unitet i çeliktë, i farkëtuar nga Partia në betejat heroike të çlirimit të atdheut dhe në transformimet e mëdha socialiste, qëndron sot në themelet e pushtetit popullor, të lirisë e të pavarësisë së atdheut dhe i bën ato të patundura e të pathyeshme. Është ky unitet ajo forcë e madhe monolite që u ka bërë ballë armiqve të egër e që ka shpartalluar intrigat e komplotet e tyre.

Në këtë unitet të Partisë e të popullit theu kokën edhe Mehmet Shehu, një nga tradhtarët dhe armiqtë më të rrezikshëm të Shqipërisë socialiste. Ai ishte kritikuar shumë herë nga Partia për gabime të rënda, por kishte mundur të kamufllohej. Sipas dokumenteve të zbuluara dhe dëshmimeve të pakontestueshme, vërtetohet se ai, qysh para luftës, ka qenë vënë në shërbim të zbulimit të fshehtë amerikan. Gjatë luftës e pas çlirimit, Mehmet Shehu luftoi e punoi në Shqipëri si mercenar i të huajve dhe nën urdhrat e tyre. Ai, që kur ishte në Brigadën I, u rekrutua edhe nga zbulimi i fshehtë jugosllav (OZNA, sot UDB), pastaj edhe nga KGB-ja sovjetike, të cilëve u ka shërbyer me zell. Me porosi dhe sipas udhëzimeve të qëndrave të huaja të spiunazhit, veçanërisht të CIA-s e të UDB-së, ai dhe grupi i komplotistëve të lidhur me të, të cilët tashmë i janë dhënë hetuesisë, kanë punuar për të shkatërruar Partinë e pushtetin popullor dhe për ta vënë Shqipërinë nën sundimin e huaj.

Për të zbatuar planet diversioniste e banditeske të caktuara nga padronët e tyre në Uashington, Beograd e gjetkë, Mehmet Shehu dhe shokët e tij ishin përgatitur për krime të rënda. Mehmet Shehu kishte marrë urdhrë nga UDB-ja jugosllave të vriste Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit, si dhe të shtypte me mjete terroriste të gjithë ata që do të ngriheshin kundër kësaj tradhtie të madhe. Në qoftë se ata nuk mundën të vepronin për të realizuar qëllimet e tyre kriminale, kjo lidhet me frikën e madhe që kishin nga populli e Partia, nga uniteti i tyre i çeliktë, i cili nuk lë asnjë armik të bëjë hap, sado dinak e i djallëzuar qoftë. Mehmet Shehu nuk mundi kurrë ta lëvizte e ta shtrembëronte vijën e Partisë, mbasi po të orvatej ta bënte këtë, do të demaskohej menjëherë.

Mehmet Shehut, i vënë mes dy zjarresh, kërkesës së UDB-së, së cilës i digjej toka nën këmbë në Kosovë, dhe frikës nga uniteti i Partisë dhe i popullit, nuk i mbeti tjetër, veçse rruga e turpshme e vetëvrasjes.

Bashkimi i madh i popullit tonë e ka burimin e vet te vija e drejtë e Partisë, që ka mishëruar e shprehur kurdoherë kërkesat historike të masave. Populli ëndërronte të jetonte i lirë dhe i pavarur në vendin e vet, të zhdukte shfrytëzimin e shtypjen shoqërore, të kapërcente prapambetjen shekullore. Ai kërkonte emancipimin e përgjithshëm të shoqërisë shqiptare, çlirimin e të gjitha forcave krijuese, zhvillimin e lirë

të aftësive e të talentëve të ndrydhura nga regjimet e kaluara. Ai donte të ishte zot në vendin e vet dhe i barabartë në marrëdhëniet me kombet e tjera.

Këto aspirata populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, i realizoi plotësisht. Ato janë një realitet i gjallë, të cilin e shohim, e prekim, e jetojmë përditë. Shqipëria socialiste është një vend dhe një shtet krejtësisht i lirë e i pavarur, që nuk i detyrohet askujt e për asgjë. Për të janë të huaja e të papranueshme tutelat e diktatet, ndërhyrjet e borxhet, nga të cilat vuajnë jo vetëm shumë shtete të vogla, por edhe të mëdha. Kurrë Shqipëria nuk ka pasur një pozitë ndërkombëtare më të fortë se sa sot.

Brenda një kohe relativisht shumë të shkurtër Shqipëria nga një vend i varfër, që vuante edhe për bukën e gojës, është bërë një vend plot me fabrika e kombinatë, me miniera e hidrocentrale, me fusha të bonifikuara e të ujtura, me shkollat e institute shkencore. Njerëzit tanë janë të ngritur politikisht e ideologjikisht, të arsimuar e të kulturuar, të aftë për të kryer me forcat e veta çdo punë që i nevojitet përparimit të atdheut e mbrojtjes së vendit. Te ne po rritet dhe edukohet një brez i ri revolucionar e patriot, i cili, me siguri, do ta çojë gjithnjë e më përpara stafetën e revolucionit, do ta ngrejë gjithnjë e më lart lavdinë e atdheut tonë socialist.

Populli ynë ka mundur t'i arrijë këto rezultate të shkëlqyera, ai ka ecur dhe ecën përpara, pse në zhvillimin ekonomik e në fushat e tjera është mbështetur tërësisht në forcat e veta, pse Partia jonë në gjithë veprimtarinë e saj ka zbatuar në mënyrë krijuese e me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit. Në Shqipëri marksizëm-leninizmi dha një provë të madhe të forcës së tij revolucionarizuese e transformuese kur ai zbatohet drejtë e me konsekuencë.

Sot, i madh e i vogël te ne e sheh me sytë e tij dhe e ndien me zemër drejtësinë e pushtetit popullor, epërsinë e padiskutueshme dhe vitalitetin e rendit tonë shoqëror socialist.

Me mundin, djersën dhe talentin krijues të popullit tonë, duke u mbështetur në burimet tona natyrore e financiare, u krijua një industri krejt e re dhe shumëdegëshe, e fuqishme dhe moderne, e shpërndarë në të gjithë territorin e vendit.

Është një krenari e ligjshme kur shikojmë të ngritur gjigantë të tillë, si: Kombinati Metalurgjik dhe sistemi unik energjetik me hidrocentralet mbi lumin Drin, pusët e naftës dhe uzinat e përpunimit të thellë të saj, uzinat kimike dhe kombinatet e tekstitit, dhjetëra miniera, kombinatë e fabrika të përpunimit të metaleve, si dhe shumë vepra të tjera madhështore.

Me prodhimet tona industriale ne plotësojmë tani nevojat e domosdoshme të popullit për një konsum që zgjerohet pa ndërprerje, plotësojmë nevojat e ekonomisë, që zhvillohet në mënyrë dinamike, plotësojmë kërkesat për fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut. Industria është bërë tashmë burimi kryesor i akumulimit socialist dhe i të ardhurave nga eksperti. Ajo është faktori i dorës së parë i mbështetjes plotësisht në forcat tona.

Është meritë e Partisë sonë që krijimin dhe zhvillimin e industrisë

i lidhi ngushtë me zhvillimin e përparimin e bujqësisë e të fshatit në rrugën e socializmit. Duke iu përmbajtur vijës që ka caktuar Partia, bujqësia jonë socialiste është fuqizuar pa ndërprerje, ajo po ecën me vendosmëri në rrugën e intensifikimit dhe të sigurimit të rendimenteve të larta. Fshat e bonifikuara e të sistemuara, kodrat e malet, të kthyer në toka buke e në plantacione me pemë frutore, krijimi i një sistemi kompleks të ujitjes, shtimi i bagëtive dhe modernizimi i blegtorisë, ngritja e parkut të gjerë të mekanikës bujqësore - ja disa nga ato arritje, që ia kanë ndryshuar rrënjësisht pamjen bujqësisë sonë.

Forcën e bujqësisë sonë socialiste dhe përparimet e saj i dëshmon edhe fakti që, me gjithë thatësinë e jashtëzakonshme të këtij viti, u prodhua grurë e misër më shumë se çdo vit tjetër në periudhën e pasqirimit. Bujqësia siguron tani në mënyrë të pavarur ushqimin e popullit, lëndët e para për industrinë e lehtë e ushqimore dhe burime të rëndësishme akumulimi e valutore. Fshati ynë socialist është i populluar dhe i lulëzuar, mënyra e jetesës së tij po afrohet gjithnjë e më shumë me atë të qytetit.

Është krijuar një sistem i gjerë transporti me hekurudha që shtrihen qindra kilometra, me një park të shumtë automjetesh dhe me një flotë detare që po fuqizohet pareshtur. Ky sistem ka forcuar karakterin unik të ekonomisë dhe ka gjallëruar së tepërmi jetën ekonomike e shoqërore të vendit.

Zhvillimi i ekonomisë, përparimi i jetës materiale, intelektuale e shpirtërore, janë shoqëruar e mbështetur nga një revolucion i vërtetë në fushën e arsimit e të kulturës, të përgatitjes së kuadrove, të shkencës e të teknikës. Njerëzit tanë, të udhëhequr nga Partia, asnjëherë nuk e kanë ndarë punën dhe veprimtarinë e tyre nga çështja e madhe e garantimit të fitoreve socialiste, e forcimit të aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë të shtrenjtë.

Katër vjet më parë, në prag të zgjedhjeve për legjislaturën e kaluar, ne denoncuam botërisht tradhtinë e revizionistëve kinezë dhe veprimtarinë e tyre antishqiptare. Armiqtë shpresuan se Shqipëria socialiste do të gjuhëzohej dhe do të drejtohej për ndihmë jashtë. Por ata dështuan në llogaritë e tyre. Pati edhe njerëz të paanshëm, që menduan se ne nuk do të bënim dot pa ndihma e kredi të huaja.

Koha e vërtetoi se Shqipëria as u përku, as u gjuhëzua, por eci përpara ballëllart me forcat e veta dhe pa ndihmën e kurrkujt, bile ecëm më shpejt dhe shkuam më larg. Por më mirë për këtë flasin faktet.

Gjatë katër vjetëve të kaluar u vunë në shfrytëzim me dhjetëra vepër industriale, bujqësore, të transportit e socialkulturore. Periudhës së legjislaturës që kaloi i takojnë vënia në shfrytëzim e hidrocentralit «Drita e Partisë» në Fierzë, furnalata e dytë, bateria e koksit dhe uzina e materialeve refraktare në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», uzina e ferrokromit në Burrel, uzina e shkrirjes së bakrit në Laç, hekurudha Laç-Shkodër, dyfishimi i kapacitetit të kombinatit të sheqerit në Maliq, ngritja e tetë rezervuarëve të mëdhenj për ujitje, si ai i Gjancit në Korçë, i Tapizës në Tiranë, i Izvorit në Tepelenë etj., ndërtimi i Muzeut Historik Kombëtar dhe i më shumë se 53 mijë apartamenteve e ndërtesave të banimit, ku u strehuan mbi 250 mijë veta në qytete e në fshatra.

Vetëm gjatë katër vjetëve të kaluar u futën në punë kryesisht në

prodhim, afro 160 mijë veta, duke aktivizuar kështu të gjitha forcat e reja të punës. Financat tona kanë forcuar qëndrueshmërinë e tyre, duke bërë të mundur që për përmirësimin e kushteve të jetesës së punonjësve, për zhvillimin e arsimit e të shëndetësisë, për sistemin e gjerë të sigurimeve shoqërore e të pensioneve dhe për nevoja të tjera të përbashkëta të përdoren afro 40 për qind e fondeve të buxhetit të shtetit. Në Shqipërinë socialiste nuk ka papunësi, s'ka inflacion, s'ka taksa e tatim mbi popullsinë. Qiratë e shtëpive janë fare të vogla.

Ulja e re e çmimeve në një sërë mallrash të konsumit të gjerë e të shërbimeve komunale është një shfaqje tjetër e kujdesit të Partisë për mirëqenien e popullit, e forcës së ekonomisë dhe e ecurisë në rrugë të drejtë të proceseve ekonomike e shoqërore në vendin tonë socialist.

Rezultatet që kemi arritur dalin edhe më mirë në pah, po të kemi parasysh se në të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste ka një rënie të madhe në ekonomi, rënie të prodhimit, papunësi, ngritje çmimesh, inflacion të madh dhe ulje të nivelit të jetesës.

Kriza e sotme ekonomike botërore në esencë është si të gjitha krizat e tjera të mëparshme. Ato, siç i ka shpjeguar Marksi dhe siç i ka vërtetuar historia, janë fenomene të pashmangshme të sistemit kapitalist. E reja në krizën aktuale është se ajo demonstroi falimentimin e teorive dhe të praktikave borgjeze e revizioniste, të shpikura për t'i shmangur ato. U vërtetua në praktikë se nxitja e prodhimit nëpërmjet shtimit artificial të konsumit të brendshëm, duke i kthyer gjithë njerëzit në borxhlinj të monopoleve, ishte e mbarsur me pasoja katastrofike për mbarë vendin. Ranë edhe mburrjet boshe për ngritjen e nivelit të jetesës me para borxh, si në Jugosllavi, ku njerëzit po detyroheshin ta kalojnë këtë dimër pa zjarr dhe me mungesa të mëdha të mallrave të përdorimit të gjerë e të dorës së parë.

Po kështu, mbështetja e zhvillimit ekonomik në borxhet e huaja, e cila u trumbetua për një kohë si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, si rruga e shpëtimit të njerëzimit, doli se ishte një strategji e robërimit të vendeve të varfëra e të dobëta nga ana e imperializmit dhe e fuqive të mëdha të industrializuara.

Përparime të mëdha janë bërë te ne në fushën e arsimit e të kulturës, të teknikës e të shkencës. Kujdesi i madh që ka treguar Partia për këta sektorë, si dhe përpjekjet që ka bërë pushteti popullor për zhvillimin e tyre kanë dhënë rezultate të shkëlqyera. Sistemi ynë arsimor është nga më të përparuarit në botë, nga më demokratikët e më popullorët. Fëmijëve tanë, kudo që ndodhen, u është krijuar mundësia të ndjekin shkollën 8-vjeçare. Shkollat e mesme kanë shkuar edhe në fshat, ku tërheqin gjithnjë e më shumë një numër tepër të madh nxënësish. Mundësi të shumta janë krijuar kudo për të ndjekur arsimin e mesëm e të lartë pa shpëputje nga puna.

Një krijimtari letrare e artistike e shëndoshë në përmbajtje dhe e larmishme në formë, po pasuron jetën shpirtërore të njerëzve tanë. Letërsia, muzika, artet figurative, filmi, teatri, televizioni etj., të udhëhequr nga Partia, kryejnë një punë të madhe edukuese, politike e ideologjike dhe luajnë një rol të madh në formimin e karakterit socialist të njerëzve tanë, në ngulitjen e normave të moralit komunist.

Partia i ka kushtuar një vëmendje të posaçme përvetësimit e zhvillimit të shkencës e të teknikës në vendin tonë. Megjithëse tradita në këta sektorë ka qenë e paktë, ky kujdes i Partisë u dha mundësi njerëzve tanë, të talentuar e të etur për dije, të mësojnë e të zbatojnë me kompetencë teknikat e ndërlikuara, që kërkon zhvillimi i shpejtë e modern i ekonomisë dhe i sektorëve të tjerë. Ngritja e një numri të konsiderueshëm institutesh të posaçme për studime shkencore, krijimi i byrove teknologjike, i grupeve të shumta të studimit etj., dëshmojnë për atë gjerësi që ka marrë te ne puna shkencore, si dhe për nevojën që ka ekonomia dhe e gjithë shoqëria për të. Në të njëjtën kohë, Partia ka punuar e punon që studimet e metodat shkencore në prodhim, organizim, drejtim e kudo të bëhen një praktikë e përditshme e njerëzve tanë.

Dëshmi e gjallë e forcës së pushtetit popullor dhe e vitalitetit të rendit shoqëror janë edhe ndryshimet e mëdha në kryeqytetin e atdheut tonë të dashur. Në këto vite Tirana është transformuar krejt. Ajo ka një popullsi mbi tetë herë më të madhe se në periudhën e paraqirimit dhe mbi 80 për qind e saj banon në ndërtesa të reja. Vetëm numri i nxënësve në shkollat e mesme është më i madh se gjithë popullsia e qytetit të Tiranës para luftës. Sot në kryeqytet punojnë e krijojnë 70 mijë punëtorë dhe sigurohet një e pesta e prodhimit industrial të vendit. Kështu si Tirana janë transformuar e rinuar të gjitha qytetet e fshatrat tona.

Me perspektivat që ka çelur Kongresi i 8-të i Partisë popullin tonë e pret një e ardhme më e lumtur dhe më e begatshme. Legjislatura e re e Kuvendit Popullor koincidon në kohë me zbatimin e planit të shtatë pesëvjeçar. Gjatë kësaj periudhe ne i kemi të gjitha mundësitë njerëzore, materiale e financiare për të ecur me vendosmëri përpara dhe për të arritur rezultate më të mëdha në të gjitha fushat. Dhe, me siguri, me punën dhe me djersën tonë ne do të arrijmë të kemi më shumë naftë e minerale, më shumë çelik, energji elektrike, drithë e produkte të tjera bujqësore e blegtorale, më shumë mallra industriale të konsumit të gjerë dhe të një cilësie më të mirë.

Ekonomia jonë do të fuqizohet akoma më shumë, zhvillimi i forcave prodhuese do të çohet akoma më përpara. Do të ndërtohen qindra vepra të rëndësishme ekonomike e sociokulturore. Industrisë do t'i shtohen vepra të tilla të mëdha si hidrocentrali i Komanit, uzina e vajrave lubrifikante, uzina e prodhimit të nikelit dhe kobaltit metalik. Do të dyfishohet prodhimi i metalurgjisë së ferrokromit, do të ngrihen disa fabrika të pasurimit të mineraleve dhe për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, do të kryhen zgjerime dhe rikonstruksione të kombinateve tekstile, të trikotazheve etj.

Gjithashtu, do të fillojnë së ndërtuari mjaft vepra të rëndësishme të metalurgjisë së zezë e me ngjyra, të hidroenergjetikës, të materialeve të ndërtimit etj. Në këtë mënyrë, industria do të fuqizohet më tej dhe do të luajë akoma më mirë rolin e saj vendimtar për përparimin e përgjithshëm të vendit.

Bujqësia do të futet më gjerësisht e mbi baza shkencore në rrugën e intensifikimit, duke hapur perspektiva të mëdha për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, për zhvillimin e mëtejshëm të jetës socialiste në fshat dhe për forcimin e pavarësisë së vendit. Në një zonë të

gjerë fushore do të bëhet intensifikimi me përparësi i prodhimit. Investime të mëdha do të bëhen për tckën, për ujitjen, për mekanizimin, për shtimin dhe përmirësimin e plantacioneve me pemë frutore, agrume dhe ullinj.

Siç jeni në dijeni, në bazë të planit të shtatë pesëvjeçar dhe të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, do të zbatohet një program i tërë për fuqizimin e mëtejshëm të transporteve tona, duke i dhënë prioritet transportit hekurudhor, që tashmë është shtrirë në drejtimet kryesore të lëvizjes së mallrave e të udhëtarëve.

Plotësimi i objektivave për zhvillimin e prodhimit do ta garantojë dhe do ta çojë akoma më përpara mirëqenien e popullit, si në qytet edhe në fshat. Do të përmirësohet pareshtur furnizimi i tregut me mallra industriale e ushqimore, do të përmirësohet struktura e konsumit të ushqimit të popullit, investime të rëndësishme do të bëhen për strehimin e popullatës, si dhe do të merren një varg masash të tjera, që synojnë të përmirësojnë më tej mirëqenien e popullit në të gjitha aspektet e jetës.

Si kurdoherë, në qendër të vëmendjes së Partisë dhe të shtetit tonë socialist do të jenë zhvillimi arsimor e kulturor i punonjësve, ruajtja dhe forcimi i shëndetit të tyre. Hapa të rinj do të bëhen edhe në sektorët e ndryshëm të kulturës, me synim që puna e tyre të shtrihet thellë në masat dhe t'i shërbejë më mirë edukimit të gjithanshëm të tyre.

Mbrojtjes së atdheut, në çdo situatë e në çdo kohë, Partia e pushteti popullor i kanë kushtuar kujdesin më të madh. Sot vendi ynë ka një mbrojtje të fuqishme që garanton lirinë e pavarësinë, të fituara me aq gjak e sakrificë, punën e tij paqësore. Detyra jonë është që këtë mbrojtje ta çelkosim gjithnjë e më shumë, për të qenë kurdoherë në gjendje dhe në gatishmëri të plotë për të shpartalluar çdo armik që do të orvatet të prekë tërësinë tokësore e sovranitetin tonë kombëtar.

Uniteti i popullit tonë është i çeliktë. Situata jonë e brendshme është e shëndoshë. Këtë e vërteton edhe dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, që do të shpallet nesër, me anën e të cilit u falet ose u zbritet dënimi mjaft të burgosurve të dënuar për fajet e ndryshme.

Kur në të gjitha vendet e botës çdo ditë ngrihen çmimet, në Shqipërinë socialiste ato ulen; kur në të gjitha vendet e botës mbushen burgjet, në Shqipërinë socialiste këto zbrazen. Kjo tregon forcën ekonomike dhe politike të pushtetit tonë të diktaturës së proletariatit.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor kanë qenë kurdoherë një manifestim i demokracisë sonë socialiste, i karakterit popullor të shtetit tonë. Njerëzit tanë kanë shkuar kurdoherë të gjithë me entuziazëm në votime dhe kanë votuar të gjithë për kandidatët e Frontit Demokratik, pse kanë qenë të ndërgjegjshëm e të bindur se kështu shprehin dashurinë për Partinë dhe besnikërinë ndaj vijës së saj, përkrahjen që ata i japin njëzëri pushtetit popullor, dënimin që u bëjnë armiqve, të jashtëm e të brendshëm, vendosmërinë për të ecur me guxim e ballëllart në rrugën e ndritur të socializmit.

Kështu ka ndodhur në të kaluarën. Kështu do të ndodhë edhe në votimet e tanishme. Pjesëmarrja në zgjedhje dhe vota për kandidatin e Frontit Demokratik janë një shprehje e pjekurisë politike e ideologjike, e ndërgjegjes klasore e patriotike, e përgjegjesisë për fatet e vendit.

Të dashur shokë e shoqe,

Aktualisht, ne po jetojmë në një situatë ndërkombëtare mjaft të nderë dhe të mbushur me kërcënime e rreziqe të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve, si dhe për paqen e sigurinë ndërkombëtare. Kjo gjendje është rezultat i intensifikimit të politikës dhe të veprimeve agresive të superfuqive imperialiste dhe të një rigjallërimit të forcave të ndryshme reaksionare, fashiste e luftënxitëse.

Si në shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe në Bashkimin Sovjetik po merr epërsi një kurs militarist e aventuresk në politikën e jashtme, po vihet në zbatim një strategji e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta ushtarake si mjet për të siguruar ekspansionin dhe hegjemoninë e tyre politike dhe ekonomike në botë. Tani objekt i kësaj mësymjeje të përgjithshme të superfuqive janë bërë jo vetëm popujt e vendet që kanë qenë jashtë zonave të sundimit të tyre, por edhe partnerët e vet më të ngushtë në aleancat ushtarake e në blloqet ekonomike.

Në këto situata popujt, natyrisht, nuk rrinë duarlidhur. Forcat revolucionare, patriotike, demokratike e paqedashëse, kudo në botë, i bëjnë një rezistencë të hapët e të vendosur politikës agresive e çnjerëzore të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik. Në Afganistan, në Lindjen e Mesme, në Salvador etj. luftohet me armë për të rifituar lirinë e shkelur dhe pavarësinë e humbur. Populli i Iranit po bën përpjekje të mëdha për të mbrojtur revolucionin e tij nga kërcënimet e shantazhet, që i bëjnë të dyja superfuqitë. Në të gjitha vendet kapitaliste, pa përjashtim, është zgjeruar shumë rezistenca e klasës punëtore për të mbrojtur të drejtat demokratike dhe ato të punës, të fituara në betejat të gjata klasore. Në një shkallë më të lartë dhe në përpjesëtime më të gjera po zhvillohet lufta e mjaft vendeve për sovranitetin kombëtar mbi lëndët e para dhe për një zhvillim të pavarur.

Këto luftëra e përpjekje përbëjnë edhe ata faktorë kryesorë që godasin sistemin kapitalist e imperialist botëror, që shkaktojnë krizat në aleancat kapitaliste dhe acarojnë kontradiktat ndër imperialiste, që frenojnë e pengojnë realizimin e planeve skllavëruese e luftënxitëse të imperializmit.

Partia dhe Qeveria jonë, si kurdoherë, i ndjekin me vëmendje proceset e ndryshme që ndodhin në botë dhe nxjerrin konkluzionet përkatëse për qëndrimet që duhet të mbajnë ndaj tyre e që t'u përgjigjen mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit e të vendit tonë. Ne mbajmë parasysh se situatat në botë nuk qëndrojnë kurrë në vend, të palëvizshme. Ato ndodhen gjithnjë në ndryshim dhe evlulojnë për mirë ose për keq, sipas raportit të forcave klasore në botë, të zhvillimit të kontradiktave të ndryshme, të krizave etj.

Tani vëmë re se në Evropë, në Mesdhe, në Lindjen e Mesme e në Ballkan, si rezultat i politikës hegjemoniste dhe i ndërhyrjeve brutale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimin Sovjetik, po krijohen tensione e konflikte të reja, të cilat rrezikojnë drejtpërdrejt paqen e sigurinë e shumë vendeve të këtyre rajoneve.

Vendet e Evropës Perëndimore e Lindore janë vënë në mengenenë e dy superfuqive, që kërkojnë tani t'u marrin jo më pasuritë, por edhe

shpirtin. Me shumë të drejtë masat e gjera popullore në shumë vende janë ngritur në demonstrata e protesta kundër vendosjes së armëve atomike amerikane e sovjetike dhe kërkojnë me këmbëngulje largimin e tyre nga kontinenti ynë i vjetër. Ato janë të ndërgjegjshme se superfuqitë, duke i futur vendet e tyre nën ombrellën e vet atomike, kërkojnë t'i mbajnë gjithnjë të nënshtruara politikisht dhe ekonomikisht dhe që Evropa e gjithë të bëhet mish për top për amerikanët e sovjetikët.

Dërgimi i njësive ushtarake të disa vendeve evropiane në Liban, krahas atyre të Shteteve të Bashkuara, pavarësisht nga justifikimet që mund të bëhen, përbën një precedent shumë të rrezikshëm për ndërhyrje ushtarake të drejtpërdrejtë në punët e brendshme të shteteve të pavarura. Ky veprim, në njëfarë mënyre, është një kthim te politika e vjetër e fuqive të mëdha evropiane, që, nën pretekstin e «shuarjes së turbullirave» e «të vendosjes së rregullit», dërgonin trupa në vende të ndryshme për të vendosur sundimin e tyre.

Mendimi i Partisë sonë është se forcimi i paqes dhe i sigurisë në Evropë, në Mesdhe ose në Lindjen e Mesme, zhvillimi e prosperiteti i shteteve evropiane, mbrojtja e kulturës, e traditave dhe e qytetërimit të tyre, ruhen e forcohen duke kundërshtuar politikën hegjemoniste të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik, duke mos u dhënë atyre asnjë mundësi të shfrytëzojnë lidhjet politike, ekonomike etj., që ekzistojnë me to, për të goditur e sulmuar vendet e tjera, për të vënë në rrezik lirinë e pavarësinë e popujve, paqen e sigurinë ndërkombëtare.

Mbrojtjen e vendeve evropiane, zhvillimi i lirë e të pavarur të tyre, sovranitetin dhe tërësinë e tyre tokësore, nuk i garantojnë as Pakti i Atlantikut, as Traktati i Varshavës, as bazat ushtarake të vendosura në shtetet e ndryshme dhe as armët atomike të superfuqive. Ato sigurohen duke i prishur këto pakte dhe duke i dërguar në shtëpitë e tyre ushtarët amerikanë e sovjetikë, duke i këputur e bërë copë-copë vargonjtë politikë, ekonomikë e ushtarakë, me të cilat Uashingtoni e Moskë kanë lidhur Evropën.

Një gjë e tillë duhet bërë edhe në Ballkan, ku superfuqitë, duke përfituar nga situatat e vështira të krijuara në ndonjë vend, kanë filluar të lëvizin, të bëjnë presione të ndryshme e të kërkojnë koncesione të reja në favor të tyre. Paqen dhe sigurinë në Ballkan i rrezikon dhënia e bazave ushtarake ose e lehtësive të ndryshme Shteteve të Bashkuara e Bashkimin Sovjetik, i rrezikon futja në borxhe deri në grykë te superfuqitë, gjë që përbën rreziqe të shumta, jo vetëm për pavarësinë e atij vendi që i ka këto borxhe, por edhe për fqinjët e tij. Dihet se, kur tapitë i ke vënë rehem dhe s'ke me se paguan, vjen një ditë që borxhdhënësi të merr jo vetëm shtëpinë, por edhe tokën ku ajo është ngritur.

Popujt e Ballkanit, në të kaluarën, kanë vuajtur mjaft dhe ata nuk dëshirojnë që harta e gadishullit tonë të ndryshojë në favor të kësaj cse të asaj superfuqie. Prandaj shtetet ballkanike nuk duhet t'u lejojnë fuqive imperialiste, në asnjë rast e në asnjë mënyrë, të futen në Ballkan, të trazojnë paqen e sigurinë e vendeve të tyre.

Shumë shqetësuese është bërë aktualisht situata në Lindjen e Mesme. Agresioni i ri izraelit kundër Libanit, i organizuar, i financuar dhe i

nxitur nga imperialistët amerikanë, ka krijuar rreziqe e kërcënime të drejtpërdrejta, jo vetëm për popujt e zonës përreth, por edhe në një hapësirë më të gjerë.

Izraeli, duke përfitur nga ndihma e madhe amerikane dhe nga përçarjet e popujve arabë, ka lëshuar brezin dhe kërkon t'i shkatërrojë, njërin pas tjetrit, të gjitha ato vende që nuk pajtohen me grabitjen e tokave arabe dhe me gjenocidin kundër popullit të shumëvuarit palestinez.

Politika e veprimtaria ekspansioniste e Izraelit në dëm të arabëve nxitet e favorizohet edhe nga politika e Bashkimit Sovjetik, nga pazarllëqet dhe komplotet e tij në prapaskenë në kurriz të popujve arabë.

Pas Kemp Dejvidit Izraeli sulmoi Libanin. Tani kërkon nënshtrimin e Jordanisë dhe kërcënon me luftë Sirinë. Nesër kujt do t'i vijë rradha, Irakut, Arabisë Saudite, Iranit? Shtabet amerikane e izraelite për këtë mendojnë e punojnë. Por a do t'i lejojnë popujt trima arabë Izraelin dhe padronin e tij amerikan të shijnë si të duan mbi kurrizin e tyre? A do të qëndrojnë këta popuj kështu të përçarë që ata t'i thyejnë e t'i shtypin një nga një, sikurse po bëjnë?

Ne besojmë se kjo nuk do të ndodhë. Popujt arabë janë popuj liri-dashës e me tradita shumë të lashta luftarake, popuj që i kanë dhënë njerëzimit një qytetërim të tërë. Ata, me siguri, do të gjejnë forca për t'u bashkuar dhe për të ndaluar agresorët sionistë që të grabisin tokat arabe dhe të shfarosin njerëzit e tyre. Sado e gjatë të jetë lufta, sado të mëdha të jenë vështirësitë dhe sado të shumta të jenë sakrificat, që do të kërkojnë, fitorja do të jetë e tyre. Me ta është e drejta, me ta është mbarë njerëzimi përparimtar. Populli ynë gjithnjë ka qenë përkrah popujve vëllezër arabë dhe çështjes së tyre të drejtë, përkrah popullit heroik palestinez. Edhe në të ardhmen lufta e drejtë e arabëve dhe e palestinezëve do të ketë mbështetjen e plotë e pa rezerva të popullit shqiptar.

Në Amerikën Latine, kohët e fundit, sidomos pas ardhjes së Reganit në fuqi, vihet re një shtim i ndërhyrjes amerikane, si dhe i intrigave të sovjetikëve. Këtij sulmi popujt e Amerikës Latine po i përgjigjen duke rritur rezistencën kundër planeve skllavëruese imperialiste. Pcpulli shqiptar e ka përkrahur dhe e përkrah këtë luftë të popujve latinoamerikanë, që u shpreh edhe në rastin e konfliktit për Malvinet, ku ne përkrahim të drejtat e pamohueshme të popullit argjentinas.

Lufta e popullit tonë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë është në favor dhe një mbështetje aktive për luftën që bëjnë popujt kundër imperializmit e reaksionit. Në të njëjtën kohë, luftën e popujve për liri e pavarësi ne e shohim si luftën tonë, si një përkrahje të madhe për çështjen tonë.

Shokë,

Në Kongresin e 8-të të Partisë janë përcaktuar dhe shprehur qartë parimet nga udhëhiqet politika e jashtme e vendit tonë, si dhe qëndrimet tona ndaj problemeve të mëdha aktuale ndërkombëtare, ndaj vendeve të veçanta, si dhe ndaj forcave e lëvizjeve të ndryshme politike në botë. Kjo politikë, si në të kaluarën, edhe sot, ka mbështetjen e plotë

të popullit tonë, mbasi ajo shpreh mendimet e dëshirat e tij, mbron interesat më të lartë të atdheut.

Populli ynë e përkrah këtë politikë, pasi ajo është një politikë krejtësisht e pavarur, që nuk influencohet nga asnjë kufizim i jashtëm, i çfarëdo natyre qoftë. Zëri i Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare është vetëm zëri i saj. Kjo është edhe një arsye që ai dëgjohet, respektohet e merret në konsideracion.

Qëndrimet tona janë të njohura. Ne e kemi thënë dhe e themi se asnjë afrim e asnjë pajtim nuk do të kemi me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik, të cilët janë armiqtë më të mëdhenj tanë dhe të të gjithë popujve. Ne do t'i kundërshtojmë me vendosmëri synimet e tyre hegjemoniste dhe do të demaskojmë pandërprerë planet agresive. Mendimi ynë është dhe jeta e ka vërtetuar se lufta dhe papajtueshmëria me imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik përbëjnë një kusht të domosdoshëm për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut, të përparimit të rrugën tonë socialiste.

Me vendet e tjera, pavarësisht nga sistemi i tyre shoqëror, si: me Francën, me Vendet Skandinave, me Zvicrën, me Belgjikën, me Holandën etj., ne jemi për marrëdhënie normale, mbi bazën e mosndërhyrjes, të barazisë e të interesit reciprok. Ne jemi për atë që këto marrëdhënie duhet t'i shërbejnë zhvillimit ekonomik, kulturor e shoqëror të të dyja palëve, forcimit të miqësisë midis popujve e shteteve sovranë dhe, në të njëjtën kohë, interesave të ruajtjes e të forcimit të paqes në botë.

Vendi ynë ka qenë dhe është për zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, gjë që e konsideron si një mjet të dobishëm e të nevojshëm për secilin vend. Por ne kërkojmë nga të gjithë partnerët tanë që ajo të bazohet vetëm në leverdinë reciproke dhe në barazinë e plotë, që ajo të jetë e lirë nga çdo presion e diskriminim. Aq më tepër, ne nuk pranojmë që marrëdhëniet tregtare të shfrytëzohen si mjet për të ndërhyrë në punët e brendshme ose për të imponuar koncepte politike e ideologjike të huaja për ne. Tregtia për ne është tregti, domethënë shkëmbim i lirë e i ekuilibruar mallrash dhe ne nuk e konfundojmë kurrë atë me marrjen e kredive, që është një gjë krejt tjetër.

Shqipëria socialiste, njerëzit tanë kanë një stimë shumë të lartë për arritjet përparimtare në kulturë, në shkencë e në teknikë nga çdo vend, për të gjitha ato vlera që i shërbejnë zhvillimit e përparimit të njerëzimit. Prandaj ne jemi për shkëmbime normale kulturore me vendet e tjera, për njohjen reciproke të arritjeve përparimtare e demokratike në këtë fushë, pa diskriminime e pa paragjykimë.

Një vëmendje të veçantë, siç është e natyrshme, vendi ynë u kushton marrëdhënieve me shtetet fqinje. Ajo që e ka frymëzuar dhe e frymëzon këtë qëndrim është dëshira për të jetuar në fqinjësi të mirë, për të pasur kurdoherë marrëdhënie të dobishme dhe për të ndërtuar një bashkëpunim normal, që bazohet në parimet e barazisë së plotë e të mosndërhyrjes në punët e brendshme të të tjerëve, të respektimit të sovranitetit kombëtar e të moscenimit të tërësisë tokësore, të shkëmbimeve mbi bazën e interesit reciprok.

Me popullin italian ne kemi lidhje të mira dhe nuk e konfundojmë atë me fashistët e Musolinin që na dogjën dhe na vranë. Në shënimet e mia të

kohës së luftës lexoj me kënaqësi fjalët që më tha në fshatin Arbanë, në afërsi të Tiranës, kur u takuam, gjeneral armate Azzi, i cili, pas kapitullimit të ushtrisë musoliniane, me gjithë armatën e tij, u dorëzua në besim të Shtabit tonë të Përgjithshëm partizan dhe të popullit shqiptar, «U jemi mirënjohës popullit dhe partizanëve shqiptarë, që shpëtuan dhe strehuan me mijëra ushtarë të mi, bij të popullit italian. Unë dhe populli italian nuk do ta harrojmë këtë bujari. Unë, — vazhdoi të më thotë gjeneral Azzi, — derisa të vdes, do të jem mik i popullit shqiptar». Dhe ai i tillë qëndroi, derisa vdiq.

Regjimet e dy vendeve tona janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, ne kemi ligjet dhe mënyrën tonë të jetesës, Italia ka të vetat. Megjithatë, ne kemi marrëdhënie normale tregtare dhe kulturore me Italinë, të cilat jemi gati t'i zgjerojmë sipas leverdisë reciproke dhe pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Në qoftë se ndonjë qeveri italiane i konsideron këto marrëdhënie pa interes për të, ajo mund të bëjë si të dojë, ne kjo nuk na prish shumë punë. Por ne mendojmë të kundërtën, marrëdhëniet janë të dobishme për të dyja palët. Ne s'jemi një vend i izoluar dhe i mbyllur, ne kemi ç't'i shesim Italisë dhe çfarë të blejmë me pare në dorë prej saj, ashtu si dhe nga shumë shtete të tjera.

Një komunitet i lavdishëm arbëresh na lidh, gjithashtu, me popullin italian. Si ne, edhe italianët nuk duhet t'i harrojmë fjalët e mira dhe gëmin e lartë të Garibaldit për shqiptarët dhe për arbëreshët.

Arbëreshët rrojnë që prej pesë shekujsh në Kalabri dhe në Sicili. Ky komunitet u ka dhënë Italisë dhe Shqipërisë njerëz të shquar. Duke jetuar në miqësi në mes të popullit italian, arbëreshët kanë ruajtur në shekuj zakonet dhe gjuhën shqipe. Ky komunitet, që na afron me popullin italian, është një faktor miqësie.

Populli shqiptar dhe populli turk duhen shumë me njëri-tjetrin. Ne me askënd nuk bëjmë «dashuri diplomatike». Kjo nuk është në zakonin e shqiptarit, por, kur japim fjalën, këtë e mbajmë dhe nuk lëvizim nga të fryjë era. Kush e shkel miqësinë dhe mirëbesimin tonë, ne e dënojmë. Me popullin vëlla turk asnjëherë nuk është lëkundur miqësia e madhe dhe e sinqertë që na lidh. Format e ndryshme të regjimit nuk e kanë lëkundur asnjëherë këtë miqësi, mbasi ajo bazohet në ndjenjat e mira të popujve tanë, bazohet në ato lidhje vëllazërore e gjaku të qindra mijë shqiptarëve, që jetojnë, punojnë, martohen, bëjnë fëmijë, vdesin e varrosen në një tokë të përbashkët me turqit.

Ne e kemi nderuar dhe e nderojmë me respekt udhëheqësin e madh të popullit turk, Mustafa Qemal Ataturkun, i cili, si një demokrat i shquar, shkatërroi Perandorinë Osmane e kalifatit dhe krijoi Turqinë e re demokratike. Le të marrin shembull nga Qemal Ataturku, që preu me shpatë «nyjen gordiane» të Perandorisë Osmane, të gjithë ata pseudodemokratë dhe pseudosocialistë që shtypin popujt, që marrin nëpër këmbë të drejtat e tyre dhe që mbajnë gjallë kolonializmin të sheqerosur me fjalë pom-zhëimisht dhe ta zhvillojmë më tej në çdo fushë.

Ne e duam dhe e respektojmë popullin grek, pse edhe ky ushqen të njëjtat ndjenja miqësie ndaj popullit shqiptar. Ne jemi të sinqertë ndaj

njëri-tjetrit. Asnjëri s'ia do tjetrit të keqen, po i do të mirën. Këto janë lidhje historike, të mbrujtura me gjakun e përbashkët, kundër të njëjve okupatorë. Ne nuk i kcnfondojmë ndjenjat e popullit grek me ato të shovinistëve.

Marrëdhëniet e miqësisë që kemi me popullin grek do t'i zhvillojmë më tej. Kapedanët shqiptarë të revolucionit grek të vitit 1821, që luftonin nën komandën e Ipsilantit, populli grek i cilëson «arvanites penemeni e palikaria arvanites» (Greqisht - arvanitë të lavdishëm, shqiptarë trima). Kapo d'Istria dhe carët rusë, kralët serbë e vojvodët moldavë e tradhtuan revolucionin grek, por arvanitasit, me Marko Boçarin në krye, me Ali pashë Tepelenën dhe me Çaparajt, i qëndruan deri në vdekje besnikë atij.

Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe qeveritë greke, të djathta, të demokracisë së re ose socialiste, miqësinë në mes popullit shqiptar dhe popullit grek e kanë konsideruar gjithnjë një ek-zigjencë të domosdoshme politike. Por, për fat të keq dhe pa asnjë arsye, që prej 40 vjetësh po mbahet në Greqi i ashtuquajtur «ligj i gjendjes së luftës me Shqipërinë», një ligj absurd, pa baza, që e dënojnë edhe populli grek, edhe populli shqiptar, edhe opinioni botëror. Çdo njeri i arsyeshëm e realist në Greqi e kupton se një ligj i tillë pengon shkurtimin e rrugëve për një zhvillim akoma më miqësor në drejtim të Artës, Prevezës, Janinës, si dhe të gjithë Greqisë.

As që kisha ndër mend të flisja sot për marrëdhëniet tona me Jugosllavinë, pse qëndrimet tona shtetërore ndaj këtij vendi i kemi shprehur me mijëra herë dhe mbetemi në ato që kemi thënë. Por detyrohem të flas, sepse krerët e Beogradit jo vetëm kanë bërë veshin e shurdhër për sa kanë vënë në dukje Partia dhe Qeveria jonë, por me të gjitha mjetet propagandistike e diplomatike kanë ngritur një fushatë të tërë shpifjesh e sulmesh kundër Shqipërisë socialiste e politikës së saj të qartë si drita e diellit. Për 40 vjet me radhë, për të mos u ngjitur më lart, krerët e Beogradit kanë nxitur sllavët e Jugut, dhe veçanërisht serbët, të rrojnë kurdoherë në armiqësi me shqiptarët që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi, ashtu edhe me Shqipërinë e pavarur e socialiste. Kjo armiqësi ndaj shqiptarëve, ky shovinizëm i egër, kjo përbuzje, kjo prirje dhe ky oreksi i papërmbajtur për të aneksuar Shqipërinë, janë ataviste në ta. Çka e bën akcma më të rrezikshme çështjen është se popujt e tjerë sllavë të Jugut s'kanë guximin ta ndalojnë këtë valë egërsie.

Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare ne i deshëm singerisht jugosllavët, Titon e kemi respektuar dhe nderuar më shumë se ç'e meritonte. Dërguam njësi të mëdha partizane, që luftuan krah për krah me njësitë partizane jugosllave dhe kosovare shqiptare në Jugosllavinë Jugore e Qendrore. Me qindra e qindra bija e bij heroikë të Shqipërisë ranë dhe u plagosën për çlirimin e Jugosllavisë, kurse tash na del një qen serb, me emër Sinan Hasani, që hedh baltë mbi gjakun e tyre. Ai bile arrin deri atje, sa të thotë se janë jugosllavët që formuan Partinë tonë, që organizuan Luftën Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe i dhanë çdo gjë Shqipërisë. Po le të lehtë, ai për atë punë paguhet.

Titoja dhe shokët e tij, si më parë dhe deri në këtë moment që po flas, dorën tonë miqësore gjithnjë e kanë refuzuar dhe kanë bërë çmos ta

pritnin. Për 40 vjet me radhë, Titoja dhe pasuesit e tij, haptazi dhe nëpërmjet agjenturave të fshehta, kanë kurditur vazhdimisht komplete për të shkatërruar Shqipërinë socialiste, për të shkatërruar Partinë tonë, për të eliminuar fizikisht shokë kryesorë të udhëheqjes. Këtë u orvatën të bënin edhe me agjentin e tyre të vjetër, tradhtarin Mehmet Shehu. Por të gjitha komplotet e tyre dështuan dhe kurdoherë do të dështojnë.

Dikur krali serb, Karagjorgjeviçi, me bandat rusomadhe të Vrangelit, solli në Shqipëri agjentin e tij, banditin Ahmet Zogu, i cili, si tradhtar i madh i atdheut, i dha Jugosllavisë dhuratë për këtë ndihmë, Shën-Naumini e Pogradecit dhe Vermoshin. Këtë gjë duan të bëjnë edhe sot krerët e Beogradit me bandat kriminele, terroriste të njëfarë vagabondi dhe trafikanti armësh, drogash dhe grash, Leka Zogut, të cilit, për çudi, një vend mik yni i jep strehim dhe e lejon të japë intervista për shtypin dhe të bëjë thirrje për përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri. Ne e kemi të faktuar se janë titistët jugosllavë ata që dërguan në bregdetin tonë grupin e banditëve të Xhevdet Mustafës, të cilët, pa marrë akoma frymë dhe pa e parë diellin e Shqipërisë, i shpartalluan pa mëshirë. Në momentin e përshtatshëm bota do t'i marrë vesh në hollësi ndodhinë dhe qëllimet e saj. Por e rrezikshme është ajo që jugosllavët, duke shkelur sovranitetin e dy vendeve mike tona dhe pa dijeninë e tyre, përgatitën dhe hodhën kriminelë te ne. Të përgatitësh banda terroriste dhe t'i hedhësh në një vend tjetër, është një akt i rëndë kriminal, i dënueshëm në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Tashti ne duam vetëm t'u themi titistëve jugosllavë: mos luani me zjarrin, se, po fillon zjarri, do të digjeni vetë në të. Sa na përket neve, ne mbrohemi dhe dimë të mbrohemi, dimë të luftojmë dhe dimë të fitojmë mbi çdo armik. Por ne s'e duam këtë rrugë të errët e me plot rreziqe që ndiqni ju. Megjithatë, në rast se na e impononi, edhe ne do t'ju përgjigjemi. Por ne u themi udhëheqësve jugosllavë të mos shkojnë nga kjo gjigjemi. Por ne u themi udhëheqësve jugosllavë të mos shkojnë nga kjo rrugë pa krye e me shumë rreziqe për të dy vendet tona, për Ballkanin, mundet edhe për Evropën. Ju, popuj sllavë të Jugut, jini përgjegjës se lejoni serbomëdhenjtë të ndezin urat e zjarrin, në vend që t'i bëni ata të arsyeshëm dhe t'i detyroni të kthejnë rrugë, t'u përmbahen parimeve e praktikave të fqinjësisë së mirë me Shqipërinë socialiste dhe të vendosin sjellje normale e paqësore me shqiptarët që rrojnë në Jugosllavi.

Ne kemi bindjen se te popujt e tjerë sllavë të Jugut, përfshirë këtu edhe serbët, ka elementë përparimtarë. Përveç rrugës së një kthese politike në qëndrimet ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve që rrojnë në Jugosllavi, nuk ka rrugë tjetër zgjidhjeje. Ne do të vazhdojmë rrugën që caktoi Kongresi i 8-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, raportin kryesor të të cilit udhëheqësit jugosllavë e lexuan së prapthi. Propozimet tona ishin sa të urta, aq dhe pajtuese, kurse rruga juaj është me shumë rreziqe për Jugosllavinë, të cilën ne e duam të qëndrojë kështu siç është. Ju nuk i merrni seriozisht fjalët tona, që janë shprehje të ndjenjave të sinqerta të popullit shqiptar. Por kjo është keq për ju. Bota do t'ju ngarkojë me përgjegjësi të rëndë.

Disa qeveri të vendeve të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po luajnë me ndjenjat dhe me interesat tona. Ne u themi atyre se nuk mund të luhet si përpara me Shqipërinë dhe me interesat e saj.

S'janë më kohërat e kaluara, kur fatet e vendit tonë mund të merreshin lehtë nëpër këmbë dhe kur prekej e copëtohej Shqipëria.

Vëllezërit tanë shqiptarë, që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, si kurdoherë, ne do të vazhdojmë t'i mbrojmë me të gjitha forcat e zemrës në të drejtat e tyre që ua njeh kushtetuta. Asnjë dyshim të mos kenë për këtë si jugosllavët, ashtu edhe opinionioni botëror. Kjo është e njohur nga e drejta ndërkombëtare dhe kështu veprohet nga të gjitha ato shtete që kanë minoritete përjashta.

Në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë ne e bëmë të qartë qëndrimin tonë ndaj Jugosllavisë dhe mbetemi të patundur në këtë qëndrim. Shkatërrimi dhe shpërbërja e Jugosllavisë nuk do të vijë kurrë nga ne. Ne jemi për stabilitetin e Federatës. Por shovinistëve serbomëdhenj, maqedonas e malazez nga një vesh u hyn dhe nga një vesh u del fjala jonë pajtuese. Atyre u janë errësuar sytë nga shovinizmi dhe megalomania. Kur ne u bëmë thirrje arsyes dhe logjikës së shëndoshë, ata vazhduan terrorin më të egër kundër shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi. Ata kanë hedhur nëpër burgje me mijëra djem e ca heroike të Kosovës, të cilët i torturojnë barbarisht dhe u kanë ngjitur një mijë epitete ofenduese. Ne u themi jugosllavëve të lirojnë të rinjtë nga burgjet, se shqiptari nuk mund t'i durojë gjatë të tilla shkelje, që u bëhen nderit të të rinjve dhe të rejave të tij, të drejtave të tyre. Të mos e mbushin kupën, se përgjigja mund të jetë me rreziqe të mëdha.

Tërë Kosova dhe viset shqiptare në Jugosllavi janë vënë nën një presion të egër shovinist ushtarak. Tash po zhvillohet në gjerësi «diferencimi», që do të thotë spiunimi i shqiptarëve nga shqiptarët në favor të forcave të errësirës serbe. Por kosovarët nuk mund ta pranojnë këtë rrugë të turpit, mbasi kjo çon në vëllavrasje, kurse serbomëdhenjtë do të qeshin e do të fërkojnë duart.

Serbët po nxitin hakmarrjen në mes shqiptarëve. Kosova po mbulohet në varfëri dhe në varre. Njerëzit s'dinë ku i kanë djemtë e vajzat. Inteligjencia shqiptare po kositet, atë e ofendojnë, e poshtërojnë, e lënë rrugëve. Të tilla persekutime s'kanë ngjarë veçse në kohën e inkvizicionit. Jo, populli shqiptar që jeton në Jugosllavi nuk do të lejojë t'i shtypet çdo gjë e shenjtë kombëtare. Shqiptari në çdo kohë e në çdo vend, kur i shkelin lirinë dhe të drejtat e ligjshme, s'e ka ulur kurrë kurrizin dhe asnjëherë s'i ka kthyer krahët armikut.

Ju, zotërinj të Beogradit, dërguat në Kosovë 60 mijë ushtarë serbë për të shtypur e për të vlarë kosovarët dhe për të frikësuar Shqipërinë socialiste. Ne nuk frikësohemi, ne gati jemi, në këmbë si një trup. Ju flitni me gjuhën e forcës, kur ne përpiqemi të flasim me gjuhën e arsyes. Por edhe ne dimë të flasim me gjuhën e forcës.

Shqipëria është një nyjë nevralgjike dhe strategjike. Evropa duhet ta ketë parasysh këtë. Disa tallen me fortifikatat tona, ndërsa vetë armatosen deri në dhëmbë e me çdo lloj armësh, të tjerë e nënçmojnë forcën tonë. Aq më keq për ta. Disa gazetarë, që shkruajnë për të marrë rryshfete, disa politikanë të kafeneve, me «analizat e planeve strategjike» të tyre dhe serbomëdhenjtë, në radhë të parë, përhapin idera dhe bëjnë insinuatat se në këto ose në ato koniunktura, bile në të tëra koniunkturat, Shqipëria do të gëlltitet nga rusi, do të anojë nga sovjeti etj.

Ne u themi serbomédhenjve, miqve të sigurtë e të fshehtë të rusëve, se dy rrugë ka për revizionistët ruso-bullgarë që të sulmojnë Shqipërinë për të dalë në pjesën e Adriatikut tonë. Njëra është rruga e Vardarit dhe e Kosovës dhe tjetra kanali i Otrantos. Në rastin e parë, pa as më të voglin dyshim, gjithë populli shqiptar, që jeton në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë, që nga Shkupi e Kaçaniku, nga Tetova e Gostivari, nga Llapi e Plavë-Gucia, do t'i presin agresorët me pushkë. Zjarr do të ndizet edhe tërë Jugosllavia dhe invadorët revizionistë ruso-bullgarë, po të arrijnë në Alpet tona, do të vijnë si nazistët gjermanë kur dolën nga Stalingradi.

Në rastin e dytë, kyçin e Otrantos e kemi ne, shqiptarët. Sazani dhe Karaburuni, pa pasur frikë se them ndonjë sekret, janë shkëmbinj të veshur me hekur e beton, ku s'kalon dot flota ushtarake sovjetike.

Në të tilla aventura, në rast se dëshirojnë të futen armiqtë ruso-bullgarë e të tjerë, duhet të dinë se shqiptarët nuk janë një shtet prej 3 milionësh, por një komb prej 6 milionësh. Popull i vogël ishte ky yni në Luftën e Dytë Botërore, por, vetëm për vetëm dhe i paarmatosur, theu e likuidoi një numër të konsiderueshëm divizione fashistësh italianë e nazistësh gjermanë. Tash kohët kanë ndryshuar në favorin e Shqipërisë socialiste, prandaj: Larg duart nga Shqipëria!

Shqipëria nuk kërcënon kërkënd, ajo dëshiron të rrojë në miqësi me të tjerët, por, po t'i preken të drejtat dhe kufijtë e saj, do t'i përgjigjet cilitdo po me atë violencë. Po kështu do t'u përgjigjet në mënyrën më të rreptë padrejtësive dhe ofezave që mund të përdorë ndokush kundër saj.

Ciltër po flas dhe ky është mendimi i patundur i gjithë popullit tonë. Ç'mendojmë, i themi, të tjerët s'kanë munguar të flasin kundër nesh, bile ata shpifin. Ne asgjë të pabazuar dhe shpifje nuk bëjmë. Këtu qëndron edhe forca jonë, prandaj popujt përparimtarë kanë respekt për Shqipërinë socialiste, ashtu sikundër edhe ne kemi shumë respekt për ta. Për këtë qëndrim të drejtë e dashamirës ne i falenderojmë nga zemra.

Zotërinjtë udhëheqës jugosllavë ia njohin vetes të drejtën për të ngritur zërin për «padrejtësitë» që bullgarët, grekët ose shqiptarët u bëkan maqedonasve të Pirinit e të Egjeut dhe pakicave fare të vogla maqedonase në Shqipëri, kurse ne, sipas tyre, nuk e paskemi këtë të drejtë. Ata na akuzojnë se «ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme» kur mbrojmë të drejtat e vëllezërve tanë brenda ligjeve të Federatës, që jo vetëm ua shkelin, por edhe i vrasin, i burgosin, i dëbojnë në emigracion, kurse në vendlindjet e tyre i zëvendësojnë me kolonë serbë dhe malazez.

Është zoti Stamboliç ai që hodhi parullën «Kosova etnikisht e pastër», që gjoja e kërkonin «nacionalistët shqiptarë». Kjo nuk është parulla e shqiptarëve, po e serbomédhenjve, e hedhur për të mbytur në gjak Kosovën. Kjo politikë terrori i trembi me të drejtë serbët dhe malazeztë që filluan të largohen nga frika dhe nga varfëria që mbulon Kosovën. Këtë krim serbomédhenjtë kërkojnë t'ua hedhin tani shqiptarëve, kurse janë ata vetë përgjegjës për shpërnguljen e serbëve e të malazezve.

Kohët e fundit jugosllavët, të ndihmuar edhe nga mikja e tyre, Rusia,

po mbledhin nga janë e nga s'janë «maqedonas të Egjeut» që t'i kenë këta dhe si pararojë për Greqinë. Një mëngjes do të na dëgjojnë veshët se edhe Aleksandri i Madh na qenkësh sllav. Pse të mos e bëjnë edhe këtë? Kanë një precedencë «historianin» rusomadh të shekullit të 19-të, Vasilevskin. Në librin e tij mbi Bizancin, ky arrin të shkruajë të zezë mbi të bardhë, se grekët e sotëm, meqë janë ortodoksë, janë sllavë, pra nuk janë pasardhësit e grekëve të vjetër të antikitetit që i lanë njerëzimit qytetërimin nga më të shkëlqyerit e botës. Thjesht dhe me bindje të plotë prej shovinisti rusomadh, Vasilevski në librin e tij thotë se «grekët e sotëm janë me origjinë sllave».

Kështu veprojnë edhe shovinistët vorio-epirotë dhe disa dhespotë grekë, të cilët, duke u mbështetur në statistikën e Fanarit, që në kohën e Sulltan Hamitit të dytë, të gjithë ortodoksët e Shqipërisë i konsiderojnë grekë. Dhe ka gati 80 vjet që këta të ashtuquajtur grekë 400 000 kanë genë dhe 400 000 kanë mbetur deri më sot. Të ashtuquajturit grekë vorio-epirotë, sipas tyre, as janë shtuar as janë pakësuar, as lindin, as vdesin. Po ashtu, edhe në «burgjet shqiptare», thonë ata, në çdo kohë e në çdo sezon, dergjen 28 mijë vorio-epirotë. Por, për fatin e keq të atyre dhespotëve grekë, që s'kanë të bëjnë fare me popullin grek, unë mund t'u them me plot përgjegjësi popullit dhe qeverisë greke se në burg, me dënime të vogla për fajë të ndryshme, ndodhen vetëm 33 minoritarë grekë nga gjithë Shqipëria dhe prej tyre vetëm 4 për çështje politike. Pse ndodh kjo me minoritetin grek në vendin tonë? Se minoritarët grekë janë nderëz të mirë, të ndershëm, si vetë populli grek, pse ata gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzon çdo nënshtetas shqiptar, pse kudo në minoritetin grek çdo gjë është në dorë të tyre. Atje, në Parti, në pushtet s'ka veçse kuarto minoritarë. Në çdo fshat të minoritetit grek ka shkolla fillore, të mesme bujqësore dhe në Gjirokastër shkollë pedagogjike greqisht. Të gjithë kuadrot e tjerë, si doktorë, agronomë, veterinerë, ekonomistë, mësues, profesorë, janë minoritarë, kudo ka shtëpi kulturore. Të ardhurat e minoritarëve janë nga më të lartat në vendin tonë. Ne, shqiptarët, rrojmë si vëllezër me minoritarët grekë në atdheun tonë të përbashkët. Minoriteti grek në Shqipëri nuk rënkon, zotërinj shovinistë vorio-epirotë, por këndin dhe lulëzon.

Sa për besimin fetar, ju s'keni pse bëheni merak. Të besojë njeriu apo të mos besojë është një e drejtë e secilit, një çështje ndërgjegjeje dhe jo një çështje institucionale dhe as dëshirë e vullneti i hozhallarëve, i dhespotëve dhe i papës së Romës.

Unë e ndjek shtypin grek dhe kam parë ç'pyetje u kanë bërë disa gazetarë grekë e gjermanoperëndimorë banorëve të minoritetit grek në vendin tonë dhe ç'përgjigje kanë marrë prej këtyre. Njëri prej këtyre gazetarëve i ka bërë këto pyetje një plake minoritare:

- «Ku e keni kishën dhe papanë?»

Ajo iu përgjigj: «As kisha, as papai nuk më shpëtuan nga agallarët dhe bejlerët. Kur sundonin ata, as bukë më dhanë të haja, as më dhanë ujë të pija, as elektrik të ndritesha, as m'i bënë djemtë dhe vajzat të mësuara. Të gjitha këto të mira m'i dha vetëm Lufta Nacionalçlirimtare, m'i dha Partia ime e Punës. Prandaj unë dua Partinë dhe jo papanë».

Gazetari vazhdoi ta pyesë plakën: «Po mëkatet që ke bërë, kujt do t'ia rrëfesh?».

Plaka përsëri iu përgjigj me një humor të hollë: «Djali më ka thënë: rro mirë në këtë botë, mitera (Greqisht - nënë), pa, kur të prezantohesh në «botën tjetër», m'i hidh mëkatet mua dhe Partisë sime».

Në botë ka me qindra e qindra milionë njerëz që s'duan të besojnë në fenë, pse çuditen atëherë me Shqipërinë socialiste?

Shteti ynë, me vullnetin e popullit të tij, është ateist dhe s'ka forcë morale dhe materiale që t'i imponojë atij diçka tjetër. Ai është zot i fateve dhe i ndjenjave të tij. Klithmat e shovinistëve vorio-epirotë nuk e shqetësojnë aspak minoritetin grek dhe Shqipërinë socialiste, edhe po të nxiten e të paguhen nën dorë nga dikush tjetër, që nuk është populli vëlla grek.

Shokë e shoqe,

Zgjedhjet e reja për deputetët e Kuvendit Popullor zhvillohen në prag të një ngjarjeje të madhe, të festimit të 70-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare.

Populli shqiptar, të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, e kanë kremtuar gjithnjë me gëzim të madh ditën e shënuar të 28 Nëntorit 1912, kur plaku i urtë e patriot Ismail Qemali ngrii flamurin në Vlorë dhe shpalli Pavarësinë e vendit.

Duke festuar këtë përvjetor të lavdishëm, ne kujtojmë luftërat le gjendare që për shekuj me radhë populli shqiptar ka bërë për lirinë e pavarësinë e atdheut, përpjekjet titanike për të ruajtur e zhvilluar gjuhën e kulturën e tij, dashurinë e tij të zjarrtë për trojet e traditat e veta.

Mirënjohja jonë dhe e brezave që do të vijnë u drejtohet atyre patriotëve shqiptarë që, edhe në kushtet më të vështira, edhe në momentet më të rënda, e mbajtën të ndezur pishtarin e atdhedashurisë, besimin e patundur se ditë të mira do të vinin medoemos edhe për popullin e tyre. Vepra e këtyre patriotëve mbetet kurdoherë frymëzuese e mobilizuese. Ajo na fton për të mbrojtur me vetëmohim lirinë e pavarësinë e atdheut, për t'i shërbyer kurdoherë me devotshmëri e deri në fund popullit, për të punuar gjithnjë pa u lodhur për të mirën dhe për nderin e Shqipërisë sonë të dashur.

Më lejoni të përfitoj nga kremtimi i jubileut të 70-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë për të përshëndetur të gjithë popullin tonë, si dhe të tërë shqiptarët patriotë në botë dhe t'i uroj me rastin e kësaj dite të shtrenjtë për zemrat tona.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor e gjejnë tërë vendin në kulmin e punëve për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 8-të të Partisë, për të realizuar detyrat e rëndësishme të planit të shtatë pesëvjeçar. Le të shërbejnë këto si frymëzim e nxitje për forcimin e mëtejshëm të unitetit të celiktë të popullit rreth Partisë, për një mobilizim e vrull më të madh

në punë, për të punuar me disiplinë e dije, për të zbatuar kudo parullën luftarake të Partisë: «Punë e vigjilencë», për ta bërë pushtetin popullor gjithnjë e më të fortë, Shqipërinë tonë socialiste më të bukur, më të pasur, më të lumtur.

Rroftë populli ynë!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë pushteti ynë popullor!